



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1823 / Prot. 16

Vlorë më, 02.09 2024

E. Ismail

VENDIM

Nr. 34, datë 30.08.2024

PËR

PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma e, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar shkresës së Administratorit të UV-së, me Nr.1590/31, prot, datë 20.08.2024, 1590/34, prot, datë 27.08.2024, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 30.08.2024

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit pagesën e mbingarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë, për vitin akademik 2023-2024 sipas propozimeve të paraqitura nga Njësitë Bazë dhe Njësitë kryesore, përveç rasteve të cituara më poshtë:
 - a) Orët e temave të diplomave pa dokumentacionin e plotë (të cilat do të merren në shqyrtim pasi të jetë dërguar në Rektorat dokumentacioni sipas procedurës së miratuar në vendimin e Senatit Akademik Nr.65, datë 14.11.2016 "Për administrimin e dokumentacionit akademik dhe administrativ të Fakulteteve dhe Departamenteve").
 - b) Orët suplementare mbi 200 në auditor për të cilat nuk ka dokumentacion argumentues nga përgjegjësit e njërive bazë (konform udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, "për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për të llogaritur orët si dhe efektin financiar të mbingarkesës.
3. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Aurela Sahaj

